



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM DIBËR

Nr. _____ Prot.

Peshkopi, më ____ . ____ .2024

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 57 , datë 25.07 .2024

PËR MASAT E SIGURIMIT

Unë **Abaz MUÇA**, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në mbështetje të neneve 42, 43, 46, pikat 1 dhe 4 dhe 52 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 4 dhe 5 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”¹, neneve 5, 7 e vijues të ligjit nr.25, të vitit 2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, të ndryshuar, Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ligjit nr.7905, datë 23.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.37, të vitit 2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.7, datë 23.07.2024 “Për masat e sigurimit”,

U D H Ë Z O J:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi dhe objektivat**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është që nëpërmjet dhënies së orientimeve të qarta për prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për zbatimin e standardeve ligjore që balancojnë nevojën për siguri të personit dhe publikut dhe efektivitetin e ndjekjes penale, me domosdoshmërinë për të respektuar liritë dhe të drejtat e

¹ Miratuar me urdhërin nr.37, datë 25.03.2024, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

njeriut, të sigurojë që masat e sigurimit kërkohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë, propocionalitetit, prezumimit të pafajësisë, mosdiskriminimit.

2. Ky udhëzim synon të arrijë objektivat e mëposhtme:

a) të nxisë një zbatim uniform të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale në përputhje me të drejtën² dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që lidhen me caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit;

b) të udhëzojë prokurorët se si duhet t'i respektojnë detyrimet e tyre ligjore dhe standardet e kërkuara;

c) të nxisë prokurorët të njihen me zhvillimin e jurisprudencës në këtë fushë dhe trajnohen në vijimësi mbi detyrimet ligjore dhe rëndësinë e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut;

ç) të sigurojë mekanizma për të monitoruar dhe ndjekur në përputhje me ligjin, rastet e zbatimit të gabuar dhe/ose në mënyrë arbitrare të detyrimeve ligjore dhe të këtij udhëzimi nga ana e prokurorit dhe drejtuesit të prokurorisë.

Neni 2

Njohja dhe zbatimi i të drejtës dhe standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare

1. Prokurorët duhet të njohin dhe të zbatojnë normat e akteve të brendshme dhe atyre ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë dhe standardet që burojnë nga jurisprudenca, si më poshtë:

a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

b) Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj shtesë;

c) ligji nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

ç) ligji nr.37, i vitit 2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;

d) vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

dh) vendimet e Gjykatës Kushtetuese;

e) vendimet e Gjykatës së Lartë për njehsimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore.

2. Duke pranuar qëllimin e Shqipërisë për integrimin me vlerat e Bashkimit Europian, si dhe për përafrimin e legjisllacionit vendas me atë të *acquis communautaire*, aktet e mëposhtëm duhet të mbahen parasysh:

a) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Paris, 10.12.1948;

b) Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (aderuar më 1991);

c) Rekomandimi (2006)13 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, drejtuar shteteve anëtare mbi përdorimin e masës së paraburgimit, kushtet në të cilat zbatohet dhe sigurimin e masave mbrojtëse kundër abuzimit.

² Protokollin nr. 15 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr.122/2015, ka shtuar në premabulën e Konventës parashikimin si vijon: “*Duke konfirmuar se Palët Kontraktuese, në përputhje me parimet e subsidiaritetit, kanë përgjegjësinë parësore të sigurojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë dhe protokollet e saj, dhe duke vepruar në këtë mënyrë ato gëzojnë një shkallë vlerësimi që i nënshtrohet juridiksionit mbikëqyrës të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut të përcaktuar nga kjo Konventë.*”.

Neni 3

Parimet e caktimit të masave të sigurimit

1. Kërkesat e prokurorit lidhur me institutet e masave të sigurimit personal, duhet të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

a) parimin e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe mbrojtjes nga arbitrariteti, sipas të cilëve, llojet, kushtet, kriteret dhe afati i masave të sigurimit të përcaktohen në ligj dhe zbatohen në përputhje me qëllimin për të cilin ligji ka autorizuar kufizimin;

b) parimin e proporcionalitetit, duke siguruar se ashpërsia e masës është proporcionale me rrezikshmërinë e veprës, të personit të dyshuar dhe nevojat e procedimit;

c) parimin e nevojës/qasjes më pak ndërhyrëse të nevojshme, sipas të cilit një masë sigurimi më e rëndë duhet të caktohet vetëm nëse një masë tjetër më e lehtë është vlerësuar dhe konsiderohet e papërshtatshme për të mbrojtur interesin personal apo publik;

ç) parimet e prezumimit të pafajësisë dhe prezumimit në favor të lirisë, duke vlerësuar se arresti në burg është përjashtim dhe jo rregull;

d) parimin e individualizimit dhe arsyetimit duke marrë në konsideratë rrethanat individuale të çështjes konkrete dhe personit të dyshuar;

dh) parimin e mosdiskriminimit, sipas të cilit vlerësimi merr në konsideratë rrethanat e çështjes dhe personat e përfshirë, pa paragjykim ose stereotipe me baza diskriminuese.

2. Në kërkesat për caktimin e masës të sigurimit, prokurori në arsyetimin e nevojës për caktimin e një mase sigurimi dhe përshtatshmërisë së saj, duhet të mbajë në konsideratë edhe këta faktorë:

a) interesin më të lartë të të miturit;

b) perspektivën gjinore (në rastin e grave dhe vajzave në konflikt me ligjin) në zbatimin e parimit të mosdiskriminimit dhe individualizimit;

c) parandalimin e riviktimizimit të viktimave të krimit, veçanërisht gratë dhe vajzat, dhe viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje;

ç) ndikimin që një masë e caktuar ka në personat që i përkasin grupeve vunerabël siç janë (por pa u kufizuar), fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, azilkërkuesit dhe emigrantët e parregullt, etj;

d) të dhënat lidhur me llojin, formën dhe përhapjen e veprës penale objekt hetimi dhe politikën penale të rekomanduar për këto vepra/subjekte.

KREU II

KËRKIMI DHE ARSYETIMI I KËRKESAVE PËR CAKTIMIN E MASAVE TË SIGURIMIT

Neni 4

Mbi paraqitjen e kërkesave lidhur me masat e sigurimit

1. Në çdo rast nevoje për paraqitjen e kërkesave për caktimin, vleftësimin, revokimin apo zëvendësimin e një mase sigurimi, prokurori duhet të grumbullojë dhe vlerësojë faktet, rrethanat, provat si dhe të kryejë vetë apo nëpërmjet policisë gjyqësore veprime procedurale të nevojshme për të provuar dyshimin e arsyeshem dhe rrethanat e tjera që mbështesin qëndrimin

tij në raport me kushtet e kriteret ligjore dhe standardet ndërkombëtare për caktimin e masave të sigurimit.

2. Kërkesa duhet të argumentojë në mënyrë shteruese dhe reale, sesi gjejnë zbatim kushtet, kriteret e standardet ligjore në çështjen konkrete. Në rastet kur kërkohet caktimi i masave të sigurimit ndaj dy ose më shumë personave, analiza kryhet për çdo person në raport edhe me rolin dhe rrethanat e tij personale.

3. Çdo masë sigurimi që kërkohet nga prokurori duhet të arsyetohet në mënyrë të individualizuar, bazuar në rrethanat konkrete të çështjes, lidhur me përshtatshmërinë e saj duke përmbytur parashtrimin e shkaqeve dhe të të dhënave për sa vijon:

a) shkallën dhe nivelin e nevojave të sigurimit, që duhen mbajtur në konsideratë për rastin konkret për të garantuar ecurinë normale të procedimit;

b) nivelin e kufizimit të lirisë të individit që i përgjigjet kësaj nevojë;

c) sanksionin që parashikohet për veprën penale;

ç) vazhdimësinë, përsëritjen, rrethanat lehtësuese e rënduese;

4. Në kërkesën për caktimin e një mase sigurimi me afat, duhet të arsyetohet në mënyrë të detyrueshme, rreziku i marrjes së provës apo vërtetësisë së saj, si kusht për aplikimin e afatit.

Neni 5

Mbi kërkesën për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”

Përveç sa parashikohet në nenin më sipër, prokurorët udhëzohen të vlerësojnë me kujdes të veçantë kërkimin e caktimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, kur është e nevojshme dhe proporcionale, në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtën për liri³, duke mbajtur në konsideratë edhe sa vijon:

a) Masa e sigurimit “Arresti në burg”, mund të kërkohet vetëm nëse masat e tjera më të lehta janë vlerësuar në përputhje me ligjin dhe rrethanat e çështjes dhe konsiderohen të pamjaftueshme për të mbrojtur interesin personal apo publik⁴;

b) Masa e sigurimit “Arresti në burg”, mund të kërkohet si masë e fundit ose e jashtëzakonshme, nëse ajo është e vetmja masë që garanton vijimin normal të procesit apo sigurinë publike.

c) Për të kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, prokurori në çdo rast duhet të vlerësojë dhe të analizojë veçanërisht edhe kriteret e mëposhtme, duke argumentuar peshën dhe raportin ndërmjet tyre:

c.1 natyrën dhe rrezikshmërinë e veçantë të veprës dhe të dyshuarit;

c.2 sanksionin që mund të caktohet nëse deklarohet fajtor;

c.3 vazhdimësinë, përsëritjen, rrethanat lehtësuese e rënduese;

c.4 moshën, shëndetin, karakterin, rrethanat shoqërore apo personale, ku vlerësohen përveç ndalimeve e përjashtimeve ligjore edhe rrethana të tjera individuale;

c.5 përmbyshjen nga ana e këtij personi të detyrimeve që mund t'i jenë caktuar në procese të tjera penale.

³ Rekomandimi (2006)13 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës drejtuar shteteve anëtare mbi përdorimin e masës së paraburgimit, kushtet në të cilat zbatohet dhe sigurimin e masave mbrojtëse kundër abuzimit.

⁴ GJEDNJ, çështja Ambruszkiewicz k. Polonisë, 2006.

Neni 6

Trajtimi me përparësi i çështjeve me të paraburgosur

1. Çështjet me të pandehur, të cilët hetohen nën masën e sigurimit “Arresti në burg” duhet të vlerësohen si çështje me përparësi për të cilat kujdesi dhe përpjekjet e duhura për hetim brenda afateve⁵, përbën një kriter vlerësues për vijueshmërinë e masës së mësipërme, krahas pranisë së kushteve dhe kriterëve që e justifikojnë atë.

2. Prokurori mbikëqyr në vijimësi afatet e paraburgimit, duke mbajtur të dhëna për çdo të pandehur të paraburgosur lidhur me çështjet e tij në ndjekje, duke u konsultuar edhe me bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Vendosen në dispozicion të prokurorit, nëse kërkohet nga ky i fundit, burime njerëzore për të ndihmuar në këtë proces.

3. Për të siguruar një proces të rregullt ligjor dhe minimizimin e zgjatjeve të panevojshme të afateve të hetimit dhe/ose paraburgimit, prokurorët të mbajnë parasysh sa vijon:

a) dhënien përparësi hetimit të çështjeve bazuar në kohëzgjatjen e të pandehurit në paraburgim;

b) rishikimin periodik të vlefshmërisë së rrethanave për shkak të të cilave u kërkua masa e sigurimit “Arresti në burg” dhe informimin periodik me shkrim të gjykatës, sipas kërkesave ligjore;

c) marrjen e masave administrative dhe procedurale për mbledhjen e provave, sigurimin e aksesit të mbrojtjes/pandehurit në proces, kontrollin e efektivitetit të punës së oficerëve të policisë gjyqësore, shmangjen e shtyrjes të seancave gjyqësore.

Neni 7

Mbi masën e sigurimit “Garancia pasurore”

1. Prokurorët nxiten të vlerësojnë kërkimin nga palët dhe/ose pranimin e caktimit të masës së sigurimit “Garancia pasurore”⁶ ose zëvendësimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” ose masës “Arresti në shtëpi” me këtë masë, kur përmbushen kushtet e kriteret ligjore dhe nëse nevojat e sigurimit e lejojnë.

2. Kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit “Garancia pasurore”, janë:

a) ndaj personit është caktuar ose kërkohet të caktohet masa e sigurimit “Arresti në burg” ose “Arresti në shtëpi”;

b) masa e sigurimit “Arresti në burg” ose “Arresti në shtëpi” është caktuar ose kërkohet të caktohet për shkak të ekzistencës së rrezikut që i pandehuri/personi nën hetim të largohet;

c) është ofruar nga vetë personi i dyshuar ose një person tjetër një shumë monetare e përshtatshme si garanci se nuk do të largohet deri në përfundim të procesit penal.

⁵ Shih kuptimin e “diligjencës së posaçme” trajtuar në Vendim Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 08.01.2009; Çështjet e GJEDNJ si: Hysa k. Shqipërisë, 2023; Buzadji k. Republikës së Moldavisë 2016; Idalov k. Rosisë, 2012; Castravet k. Moldavisë, 2007; McKay k. Mbretërisë së Bashkuar, 2006; Sarban k. Moldavisë, 2005; Belchev k. Bullgarisë, 2004; Smirnova k. Rosisë, 2003; Labita k. Italisë, 2000; Assenov dhe të tjerë k. Bullgarisë, 1998; Mansur k. Turqisë, 1995; etj.

⁶ Shih nenin 28, pikën 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 236 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 8

Kërkesa për caktimin e masës së sigurimit ndaj të miturit

1. Prokurori në kërkesën për caktim të masave të sigurimit ndaj të miturit, në përputhje me Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, arsyeton interesin më të lartë të të miturit, nevojat specifike të tij dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative, të mirërritjes dhe të zhvillimit normal të të miturit.

2. Masa e sigurimit “Arresti në burg”, mund kërkohet ndaj të miturit vetëm si alternativë e fundit dhe vetëm nëse ekziston, përveç sa parashikohet në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale detajuar në nenin 5 të këtij udhëzimi edhe ndonjë nga kriteret e mëposhtme:

a) sanksioni i parashikuar për veprën penale, për të cilën ai akuzohet është me burgim dhe ka minimumin e dënimit mbi 7 vjet;

b) masa është e domosdoshme, sepse i mituri:

i. përbën rrezik serioz për të dhe/ose për të tjerët dhe ky rrezik nuk mund të mënjanohet me ndonjë mënyrë tjetër;

ii. përpiqet t'i shmanget drejtësisë.

KREU III

MBIKËQYRJA E EKZEKUTIMIT DHE ZBATIMI I MASËS SË SIGURIMIT “ARRESTI NË BURG”

Neni 9

Mbikëqyrja e ekzekutimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”⁷

1. Prokurori në cilësinë e autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimit penal që miraton kërkesën për masën e sigurimit me arrest, kontrollon ligjshmërinë e ekzekutimit të vendimit sipas urdhërimeve të gjykatës dhe verifikon gjatë gjithë kohëzgjatjes së masës ligjshmërinë e procedurave ose urdhrave të shërbimeve të burgjeve lidhur me ekzekutimin e saj.

2. Në rast të evidentimit të shkeljeve sipas pikës 1 të këtij neni, prokurori merr masat e duhura për të rivendosur ligjshmërinë dhe kur është rasti, fillon procedimin penal dhe/ose kërkon fillimin e procesit disiplinor për shkelësin.

Neni 10

Mbikëqyrja e dhunës në paraburgim

1. Në çdo rast kur prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, konstaton përdorimin e dhunës ndaj të paraburgosurit ose kur këta të fundit ankohen për keqtrajtim/dhunë të çfarëdo forme

⁷ Shih nenin 8 të ligjit nr.79, të vitit 2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, me përmbajtjen: “Prokurori është i detyruar të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vendimit penal në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e këtij ligji, si dhe të kontrollojë rregullsinë e ekzekutimit. Në rast të konstatimit të parregullsive, prokurori ka të drejtë t'i kërkojë organit përgjegjës ose gjykatës rivendosjen e të drejtës së shkelur, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.”.

nga ana e punonjësve publikë të ngarkuar me kujdesin/mbikëqyrjen/ruajtjen e tyre, ose kur merret dijëni nëpërmjet kallëzimit ose referimit, prokurorët udhëzohen që të veprojnë menjëherë për të verifikuar keqtrajtimin/dhunën, duke vlerësuar dhe vendosur sipas rastit regjistrimin kryesisht të njoftimit të veprës penale, dhe të njoftojnë për keqtrajtimin autoritetin epror dhe/ose inspektues të subjektit shkelës të dyshuar.

2. Në çdo rast kur merret dijëni nga burime të hapura por jo vetëm, për përdorim të dhunës nga ana e punonjësve publikë të ngarkuar me kujdesin/mbikëqyrjen/ruajtjen e të paraburgosurve, drejtuesi i prokurorisë, udhëzohet që me iniciativën e tij të vlerësojë dhe vendosë sipas rastit regjistrimin kryesisht të njoftimit të veprës penale, dhe të njoftojë për keqtrajtimin autoritetin epror dhe/ose inspektues të subjektit shkelës të dyshuar.

3. Për caktimin për ndjekje të çështjes lidhur me keqtrajtimin/dhunën ndaj të paraburgosurit nga ana e punonjësve publikë, përjashtimisht nga parashikimi i Kreut V, pika 1, fjalia e dytë, e udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.3, të vitit 2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, të ndryshuar, zbatohen rregullat e përgjithshme të shpërndarjes së çështjeve me short, ku prokurori që ndjek çështjen penale ndaj të paraburgosurit, përjashtohet nga shorti.

Neni 11

Ecuria e kërkesave gjatë zbatimit të masës së sigurimit

1. Prokurori duhet të vlerësojë me kujdesin e duhur ecurinë e masave të sigurimit edhe gjatë zbatimit të tyre. Ai ka detyrimin të kërkojë menjëherë në gjykatë zbutjen apo revokimin e masës së sigurimit, kur nuk ekzistojnë më nevojat e sigurimit apo mungojnë kushtet dhe kriteret e zbatimit të tyre.

2. Në rastet kur është urdhëruar caktimi i masës së sigurimit me afat për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës, prokurori menjëherë pasi administron provën në përputhje me parashikimet procedurale, pa pritur mbarimin e afatit, kërkon në gjykatë sipas rastit, revokimin e masës së sigurimit ose nëse nevojat e sigurimit e diktojnë, caktimin/zëvendësimin e masës së sigurimit duke analizuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe ato të parashikuara në nenet 3, 4 e 5 të këtij udhëzimi.

3. Kur nevojat e sigurimit rëndohen, prokurori kërkon në gjykatë zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më të rëndë, duke analizuar shkaqet dhe rrethanat që tregojnë këtë nevojë, si dhe përshtatshmërinë e masës së kërkuar në përputhje me kushtet e kriteret ligjore dhe ato të parashikuara në nenet 3, 4 e 5 të këtij udhëzimi.

4. Kur shkelen detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, prokurori analizon në mënyrë të detajuar kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj dhe të referuara në këtë udhëzim, për të kërkuar caktimin e një mase më të rëndë.

5. Prokurori kur vlerëson se kanë ndryshuar kushtet dhe kriteret për zbatimin/vijimin e masës së sigurimit si pasojë e ndryshimit të cilësimit juridik ose ndonjë rrethane të kryerjes së veprës penale, përpara dërgimit të kërkesës për revokim apo zëvendësim të masës në gjykatë, duhet të formalizojë paraprakisht këto ndryshime me aktet procedurale të nevojshme, sipas rastit.

6. Gjatë shqyrtimit të kërkesave për zëvendësim apo revokim të masës së sigurimit, të kërkuara nga i pandehuri, prokurori si subjekti që ka iniciuar caktimin e masës, duhet të shprehë

para gjykatës një qëndrim të qartë e të argumentuar mbi kërkesën. Sa më sipër, duhet të mbahet në konsideratë dhe në raport me kërkesat për zëvendësim të masës të bëra nga i pandehuri dhe/ose mbrojtësi.

Neni 12

Kërkesa për zgjatjen e afatit të paraburgimit

1. Paraburgimi duhet të zgjasë vetëm për atë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit për të cilin u caktua.

2. Gjatë hetimeve paraprake prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit që janë në mbarim e sipër, vetëm nëse plotësohen në mënyrë kumulative këto kushte:

- a) ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi;
- b) për hetimin janë të nevojshme verifikime veçanërisht komplekse;
- c) kohëzgjatja e paraburgimit nuk kalon gjysmën e maksimumit të dënimit të parashikuar për veprën penale për të cilën procedohet i pandehuri/personi nën hetim, pavarësisht afatit tërësor të përcaktuar nga ligji për kohëzgjatjen e paraburgimit.

KREU IV

BASHKËPUNIMI DHE NGRITJA E KAPACITETEVE

Neni 13

Bashkëpunimi

Në ushtrimin e përgjegjësive të tyre, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër duhet të vendosë dhe zhvillojë, kur është e përshtatshme, bashkëpunim me Avokatin e Popullin, institucione të tjera të shtetërore dhe organizata të shoqërisë civile të angazhuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut veçanërisht në sistemin penitenciar.

Neni 14

Trajnimi

Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë të drejtë dhe detyrim të trajnohen mbi kuadrin legjislativ ndërkombëtar dhe kombëtar në këto fusha.

KREU V

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, MBIKËQYRJA, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 15

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbëjnë vepër penale, mund të përbëjnë

shkelje disiplinore sipas ligjit⁸ dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga Sektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj oficerit të policisë gjyqësore dhe/ose prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas ligjit.

Neni 16

Zbatimi dhe mbikëqyrja

Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në strukturat hetimore përkatëse të shërbimeve dhe të seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër⁹.


Neni 17

Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe depozitimit në sekretari dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

DREJTUESI

ABAZ MUÇA



⁸ Shih nenin 101, pika 1, shkronjat “a” e “b” dhe nenin 102, pika 1, shkronjat “ç”, “d”, “dh”, “ë”, “g”, “j”, “l”, “ll” e “nj” dhe pika 2, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” e vijues të ligjit nr.96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.48, të vitit 2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””.

⁹ Shih nenet 46, pika 2 dhe 103 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.